



UNIVERSITETI I MITROVICËS 'ISA BOLETINI'

Modeli i Programit mësimor të lëndës (Syllabusi)

Fakulteti:	Ekonomik	
Programi:	Biznes dhe menaxhment	
Specializimi:	Specializimi: Menaxhment dhe Ndërmarrësi	
Niveli:	Bachelor (BSc)	
Kodi i lëndës:		
Lënda:	Ndërmarrësia	
Statusi i lëndës:	Obligative	(Obligative apo zgjedhore)
Semestri:	IV	(Dimëror / Veror)
Fondi i orëve:	3+1	(Sipas programit të aprovuar)
ECTS:	8	(Sipas programit të aprovuar)
Orari/Salla		
Viti akademik:	2022/2023	
Mësimdhënës/e:	Prof. Asoc. Dr. Ajtene Avdullahi	
Asistent/e:		
Kontaktet:	Professor	Asistent/e
Email:	ajtene.avdullahi@umib.net	
Telefon:	+38345/403200	

PERMB AJTJE	Kjo lëndë është dizajnuar për të ofruar një përvojë akademike të rëndësishme shoqërore, për të ndihmuar studentët të fitojnë njohuri. Lënda është krijuar për t'i ndihmuar studentët të kuptojnë se çfarë do të thotë të jesh ndërmarrës, për t'i ndihmuar ata të njohin potencialin ndërmarrës brenda tyre dhe të tjerëve në rrethinat e tyre. Për më tepër, kjo i ndihmon ata të vendosin nëse duan të ndjekin një rrugë ndërmarrëse dhe t'u japë atyre disa njohuri dhe teknika themelore për të ndjekur me sukses një rrugë të tillë.
QËLLIM I	Lënda synon të ndihmojë pjesëmarrësit të identifikojnë dhe vlerësojnë mundësitë e biznesit dhe të jenë në gjendje të zhvillojnë një ide biznesi në një koncept biznesi dhe të fillojnë me sukses një ndërmarrje të re.

ARRITSHMËRI A	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: • <u>Të përshkruajnë</u> procesin se si themelohen ndërmarrjet, si rriten, si dhe ndikimin e një ndërmarrësi në këtë proces, • <u>Të analizojnë</u> tendencat në ndryshim mjedisor (ndryshimet ekonomike, sociale, teknologjike, politike, rregullatore dhe demografike), • <u>Të zbatojnë</u> çështjet etike dhe zgjidhjet në situata të ndryshme biznesi, • <u>Të vlerësojnë</u> matjet kryesore të performancës së biznesit bazuar në analizën e pasqyrave financiare, • <u>Të zhvillojnë</u> aftësi të të menduarit kritik për zhvillimin e një karriere si ndërmarrës, dhe • <u>Të krijojnë</u> aftësi të të menduarit kritik për të zgjidhur problemet reale të ndërmarrësisë dhe NVM-ve.	
PROGRAMI	Javët	Temat
	Java - I	Prezentimi i lëndës, syllabusit dhe literaturës
	Java - II	Ndërmarrësia, ndërmarrja dhe ndërmarrësi
	Java - III	Njohja e mundësive ndërmarrëse
	Java - IV	Analiza dhe hulumtimi i tregut
	Java - V	Studimi i fizibilitetit
	Java - VI	SWOT analiza
	Java - VII	PEST analiza
	Java - VIII	Testi i parë
	Java - IX	Ideja ndërmarrëse
	Java - X	Blerësit dhe furnitorët
	Java - XI	Analiza e pesë forcave të Porterit
	Java - XII	Përgatitja, krijimi dhe dalja në treg e ndërmarrjes (Startup-it)
	Java - XIII	Menaxhimi i ndërmarrjes dhe inovacionit
	Java - XIV	Prezentimi i planit të biznesit për një ndërmarrje (punë dhe prezentim i grupeve të studentëve, si dhe vlerësimi i prezantimeve të kolegëve)
	Java - XV	Testi i dytë

LITERATURA	Literatura bazë: 1. Emeric Solymossy dhe Safet Merovci (2016). Ndërmarrësia, Prishtinë, 2016, Universiteti i Prishtinës, 2016 2. Bruce R. Barringer and R. Duane Ireland (2019). Entrepreneurship – Successfully Launching New Ventures, 6th Edition- Pearson. 3. Stokes & Wilson (2010). Small Business Management and Entrepreneurship, , Sixth Edition.
METODOLOGJIA E MËSIMDHËNJËS	Lënda përmban 15 javë me 2 orë ligjerata dhe 1 ushtrime (raste studimore, seminare dhe diskutime) si dhe dy kollokfiume janë planifikuar brenda këtij semestri. Kollokfiumet do të mbahen brenda 15 javëve të planifikuara (java 7 dhe 15). Çdo orë do të përbëhet nga një kombinim i ligjëratave të shkurtra, studimeve të rasteve, diskutimeve në grupe të vogla dhe / ose filma dhe dokumentarë, në varësi të materialit në dispozicion. Studentët inkurajohen të ndjekin zhvillimet aktuale të ndërmarrësisë, duke lexuar artikuj relevantë, gazeta ekonomike dhe materiale të tjera. Ata mund të identifikojnë çështjet / temat për diskutime nga këto lexime. Më pas diskutohen esetë e përgatitura nga studentët. Duke pasur parasysh se pjesëmarrja e studentëve në diskutime është e rëndësishë të veçantë, ata inkurajohen të diskutojnë duke u rikujtuar atyre se nuk ka përgjigje "të drejtë" ose "të gabuar" kur diskutojnë temat. Në pjesën më të madhe të kohës, çështjet duhet të diskutohen dhe të ballafaqohen dhe nuk kanë zgjidhje të thjeshta dhe të menjëhershme. E rëndësishme është që ata të mendojnë dhe të tentojnë të gjejnë zgjidhje për çështjet dhe temat e trajtuara. Studentët do të ndahen në grupe pune. Ata do të kenë detyra individuale dhe një detyrë në grup. Ata do të prezantojnë punimet e tyre individuale si dhe ato ekipore, e gjithashtu do të vlerësojnë dhe kritikojnë njëri tjetrin. Gjatë kursit do të organizohet vizitë e ndonjë ndërmarrje. Sipas mundësisë, do të ftohen në ligjërata edhe ndërmarrës të suksesshëm si guest speaker, të cilët do të ndajnë përvojat e tyre me studentë. Raporti midis pjesës teorike dhe praktike të studimit Teorikisht, do të sigurohet njohuri e përgjithshme shkencore e bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike do të realizohet kryesisht përmes shembujve konkretë nga literatura dhe njohuritë praktike të ndërmarrjeve private dhe publike të prodhimit dhe organizatave fitimprurëse. Marrëdhënia midis pjesës teorike dhe asaj praktike jepet në pjesën tabelare të programit të studimit. Raporti teori-praktike: 60% teori dhe 40% praktikë / studim rasti / punim seminarik (projekti).

	Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)			
	Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
	Ligjërata	3	15	45
	Ushtrime teorike	1	15	15
	Ushtrime në terren	1	15	15
	Punë praktike	1	15	15
	Konsultime me mësimdhënësin/asistenten	1	6	6
	Kolokiume /seminare	1	2	2
	Detyra të pavarura	2	15	30
	Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
	Përgatitja përfundimtare për provim	2	12	24
	Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	8	8
	Projektet, prezantimet, etj	1	10	10
	Total:			200
VLERËS IMI	Metodat e vlerësimit			
	[sipas Statutit dhe Rregullores për studime të UMIB-it]			
	Testet/Kollokviumet	2*20%=40%		
	Test praktik gjatë ushtrimeve			
	Punim seminarik	10%		
	Interpretimi dhe prezentimi i punimit seminarik	10%		
	Detyrat dhe kurset gjatë semestrit	10%		
	Provimi final	30%		

POLITI KAT AKADE MIKE	Udhëzime të mëtejme : ● Puna me kompjuter Punimet me shkrim duhet doemos të jenë të shkruara me kompjuter. Në punime janë të obligueshme respektimi i kriterëve qoftë për aspektin vizual ashtu edhe përmbajtjesor të punimeve të kërkuara. Gjatë punimeve kërkohet që të respektohen rregullat drejtshkrimore dhe stili APA ● Etika në mësim Punimet e ndryshme semestrale duhet të jenë punime të secilit student. Nuk do të ketë tolerancë për kopjime, “huazime” nga interneti apo çfarëdo materiali tjetër. Punimet e njëjta apo të ngjashme do të kenë vlerësime negative në vlerësimin përfundimtar të studentit. ● Afatet Në marrëveshje me studentët do të përcaktohen afatet e dorëzimit të punimeve. Nuk do të ketë tolerancë për vonesë në dorëzimin e punimeve. Mosardhja në orën kur është shpjeguar detyra nuk e arsyeton studentin për mosdorëzim të punimit. Afati do të jepet më herët. Po qe se do të udhëtoni jashtë vendit, atëherë duhet të dorëzoni punimi më herët. Studenti/ja ka të drejtë të kërkojë konsultim me profesorin sa herë e sheh të arsyeshme dhe të nevojshme për kryerjen e punimit të tij/saj. ● Rregullat e mirësjelljes dhe politikat akademike : - o pjesëmarrje aktive e studentëve në ligjërata - o pjesëmarrje në diskutim, komente dhe shprehje e lirë e opinionit, mendimit dhe qëndrimit akademik (me argumente) - o e obligueshme puna e pavarur dhe shfrytëzimi i burimeve shtesë të informacionit (web-faqet e ndryshme shkencore, revista shkencore, përmbledhje punimesh të konferencave etj.) - o respektimi i orareve të ligjëratave pa cenuar lirinë akademike (telefonat celularë pa zë) - o respektimi i fjalës, mendimeve dhe ideve të kolegëve - o tolerancë e ulët ndaj ardhjeve me vonesë dhe daljeve pa ndonjë arsye të qëndrueshme - o përgatitja dhe pajisja me ligjëratat përkatëse, (obligim i mësimdhënësit).
--	--

Mitrovicë

Profesori i lëndës:

03/01/2022

Prof. Ass. Dr. Ajtene Avdullahi

(Name Surname)

(Signature)